



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.05.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditë:

Tryezë konsultimi publik për projektligjin “Për provimin e shtetit për profesionin e juristit”

Të ftuar:

Artur Metani – përfaqësues nga Kryeministria
Kleina Kasanai - këshilltare e zëvendëskryeministres
Toni Gogu – zëvendësministër i Drejtësisë
Adrian Shega - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë
Ervin Demo – Zëvendësministër i Arsimit
Erzen Tola - Drejtor Juridik në Ministrinë e Arsimit
Kejda Meta – përfaqësuese e Departamentit të Administratës Publike
Ilva Valle - përfaqësuese e Departamentit të Administratës Publike
Borana Mustafaraj – profesoreshë në Shkollën e Magjistraturës
Artan Hoxha – dekan i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës
Zhaklina Peto - Departamenti i së Drejtës Civile në Universitetin e Tiranës
Kestrin Katro – përfaqësuese nga Universiteti i Tiranës
Rezana Konomi - dekane e shkollës së lartë universitare jopublike "Luarasi"
Entela Baci – përfaqësuese e Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër
Maks Haxhia – Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë
Rezarta Abdiu – përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Avokatisë
Fatmir Lacej – përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë
Mariana Semini - eksperte e grupit të punës

Agnes Bernhard - shefe e misionit ndërkombëtar "EURALIUS"

Tedi Dobi - ekspert vendas

Dorian Matlija – përfaqësuese nga Res Publica

Irene Dule – përfaqësuese nga Res Publica

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje të gjithëve!

E kemi thirrur këtë tryezë të konsultimit publik për një nga projektligjet e reformës në drejtësi “Për provimin e shtetit për profesionin e juristit”. Është një projektligj që bën pjesë në paketën e dytë të projektligjeve të reformës në drejtësi, pra, paketa e dytë prej 27 ligjesh që i referohet shtyllës së pestë të reformës në drejtësi dhe që ka të bëjë me edukimin juridik. Janë dy projektligje që i përkasin kësaj shtylle: njëri është për provimin e shtetit dhe tjetri për projektstrategjinë e edukimit ligjor të shtetasve.

Ky projektligj është në programin e punës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike. Në praktikën e punës së këtij komisioni të gjitha projektligjet e reformës janë zhvilluar tryeza të vazhdueshme të konsultimit publik me grupet e interesit. Natyrisht, për projektligje të caktuara ka pasur jo vetëm një apo dy tryeza të konsultimit publik, por më shumë. Ky projektligj është i rëndësishëm dhe prek drejtpërdrejt shumë sektorë, duke filluar me Fakultetin e Drejtësisë, me shërbimet e profesioneve të lira në Republikën e Shqipërisë dhe këtu kam parasysh avokatinë, noterinë, përmbarrimin privat dhe jo vetëm. Kemi marrë shumë komente nga aktorë dhe faktorë, që kanë akses të drejtpërdrejtë në reformën e sistemit të drejtësisë, po ashtu kemi marrë sugjerime dhe komente edhe nga ekspertë vendas, nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë Noterisë, por në veçanti nga fakultetet e drejtësisë, qoftë të universiteteve publike dhe jopublike.

Për të pasur një shkëmbim të drejtpërdrejtë mendimesh dhe idesh në lidhje me projektligjin “Për provimin e shtetit për profesionin e juristit”, ne menduam të organizojmë këtë tryezë, që të mos jemi në atë formën e komunikimi virtual nëpërmjet postës elektronike me komente për nene të caktuara, apo për projektligjin në tërësi, por të jemi në një tryezë të përbashkët për të diskutuar në lidhje me domosdoshmërinë ose jo në këtë moment të miratimit të projektligjit. Le ta themi hapur që në fillim, se ka mendime pro dhe kundër, nëse duhet ta kemi pjesë të korpusit të edukimit juridik, në këtë moment, këtë projektligj, që po diskutohet në Komisionin e Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Për këtë qëllim, nga ana e sekretarisë së Komisionit të Ligjeve janë ftuar pothuajse të gjitha universitetet publike dhe jopublike. Janë ftuar, sigurisht: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, DAP-i, Shkolla e Magjistraturës, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe, natyrisht, është ftuar edhe misioni EURALIUS, dhe këtu kemi prezent edhe shefen e këtij misioni, zonjën Agnes Bernhard, sepse dihet që misioni EURALIUS është partneri ynë kryesor jo vetëm për sa u përket ligjeve të reformës në drejtësi, por edhe për të gjithë afrimin e legjislacionit tonë me legjislacionin e BE-së.

Kështu që, pasi të hapim diskutimin dhe debatin lidhur me këtë projektligj, nëse do të harroj ndonjë nga pjesëmarrësit në këtë tryezë, ftoj të gjithë pjesëmarrësit të vetëprezantohen. Më lejoni t'ju them që kanë konfirmuar pjesëmarrjen, me aq sa sekretaria më ka vënë në dispozicion, nga Kryeministria ka dy përfaqësues, zoti Artur Metani dhe zonja Kleina Kasanai. Nga Ministria e Drejtësië është zoti Toni Gogu, Zëvendësministër dhe zoti Adrian Shega, Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit. Nga Ministria e Arsimit janë zoti Ervin Demo, zëvendësministër, dhe zoti Ervin Tola, Drejtor Juridik, nga DAP-i janë zonja Kejda Meta dhe zonja Ilva Valle, nga Shkolla e Magjistraturës kemi profesoreshën Mariana Semini, Borana Mustafaraj dhe Arta Mano, Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës përfaqësohet nga dekan, zoti Artan Hoxha, zonja Zhaklina Peto nga Departamenti i të Drejtës Civile dhe zonja Keslin Katra dhe shkolla e lartë universitare jopublike “Luarasi” përfaqësohet nga zonja Rezarta Konomi, dekanE, Universiteti i New York-ut përfaqësohet nga zoti Hektor Rusi, Universiteti “Luigj Gurakuqi” në Shkodër përfaqësohet nga zonja Entela Baçi.

Nuk e di a janë në sallë këta që kanë konfirmuar pjesëmarrjen?!

Dhoma Kombëtare e Avokatisë përfaqësohet nga zoti Maks Haxhia, kryetar dhe zonja Rezarta Abdiu, Dhoma Kombëtare e Noterisë nga zoti Fatmir Laçaj, nga “Res publika” janë zoti Dorian Matlija dhe zonja Irene Dule dhe nga misioni EURALIUS zonja Agnes Bernhard.

Natyrisht, në këtë tryezë diskutimi për këtë projektligj janë me mua kolegët e Komisionit të Ligjeve, zonja Vasilika Hysi dhe zonja Klotilda Bushka, që është propozuesja e këtij projektligji, kurse zonja Hysi është relatore.

Falënderoj edhe mediet që kanë treguar interes edhe pse është tryezë konsultimi publik! Më tepër është një mbledhje e karakterit të një grupi pune për këtë projektligj. Gjithmonë me mirëkuptimin e medieve, se besoj që janë mjaftueshëm për fillimin e diskutimit të këtij projektligji. Më vonë kjo do të jetë një mbledhje pune ku do të shkëmbehen ide dhe debate rreth këtij projektligji. Jeni të ftuar ta pasqyroni dhe të qëndroni në sallë, gjithsesi ne ju falënderojmë për interesin që keni treguar!

Pa humbur kohë unë do t'ia jap fjalën koleges Klotilda Bushka për të bërë një prezantim të nismës dhe të gjetjeve të këtij projektligji, pastaj debatin do ta konsideroj të hapur.

Ju faleminderit!

Fjala është për ju.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit, që i jeni përgjigjur ftesës sonë!

Unë nuk dua të përsëris çfarë tha kryetari i Komisionit, zoti Manja, në lidhje me nismën, por dua të them që është pjesë e të gjitha ligjeve të paketës së reformës në drejtësi. Qëllimi i këtij takimi nuk është për të diskutuar atë material që është nisur, sepse për ata që e njohin të gjithë procesin e reformës në drejtësi, të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve, një grup ekspertësh të nivelit të lartë, i atashuar pranë komisionit përkatës këtu në Kuvend dhe më tej pranë Komisionit të Ligjeve, ka hartuar draftet e para të të gjitha projektakteve të reformës dhe më pas puna ka vijuar në komisione me përmirësimin, me ndryshimet e mëtejshme, që ua kanë shtuar vlerën dispozitave, deri në miratimin e tyre, ashtu siç do të ndodhë për të gjitha ato ligje, që tashmë janë nisma, por nuk kanë filluar ende të shqyrtohen. Para se të fillojë ky proces për këtë projektligj sa i takon provimit të shtetit për profesionin e juristit, duke u nisur nga mendimet e ndryshme të aktorëve dhe grupeve të interesit për domosdoshmërinë e pasjes së një ligji të tillë, është shumë e rëndësishme që ne ta bëjmë këtë diskutim duke iu referuar dy çështjeve të rëndësishme.

Çështja e parë ka të bëjë me faktin që edhe në nenin 82 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë”, por edhe në ligjin nr. 10/171 të vitit 2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, kemi tashmë një parashikim ligjor, i cili mund të jetë si një fillesë për të pasur këtë nismë për projektligjin “Për provimin e shtetit për profesionin e juristit”. Në momentin kur kjo lloj nisme u fut në pjesën e ligjeve të reformës në drejtësi, nuk ishte krijuar ende infrastruktura e qartë se çfarë do të ndodhte me të gjitha profesionet e tjera, pra, si do të ishte përmbajtja e ligjeve specifike, që kishin të bënin me avokatinë, me noterinë, me përmbarrimin dhe, më kryesorja, si do të ishte e gjithë arkitektura ligjore sa i takon edukimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, duke paracaktuar në njëfarë mënyre edhe rolin e shtuar dhe cilësor që do t’i jepej Shkollës së Magjistraturës. I them të gjitha këto, për t’ju vënë në dijeni me faktin se, kur është menduar të kishim një nismë të tillë, nuk ishim ende në procesin e përfundimit të gjithë asaj forme, që do të merrnim në të ardhmen, si pasojë e reformës në drejtësi, të gjitha profesionet e lira, por edhe mënyra se si edukohen sot në Republikën e Shqipërisë gjyqtarët dhe prokurorët.

Pra, kemi një ndryshim të situatës së kuadrit ligjor nga momenti që reforma në drejtësi nisi në letër e deri më sot.

Ju e dini që sot kemi një parashikim ligjor në Kushtetutë, që e ka ndryshuar tërësisht mënyrën si gjyqtarët dhe prokurorët dalin nga Shkolla e Magjistraturës, llojet e hapave që ndiqen, provimet përkatëse dhe edukimin në Shkollën e Magjistraturës para provimeve. Sot kemi avokatë dhe noterë, të cilët nënshtrohen sipas ligjeve dhe sipas projektakteve, që janë në proces, si për shembull ligji “Për avokatinë”, i cili është në proces shqyrtimi nën për nen në komisionin tonë, ku bëhet fjalë edhe për një edukim pas Fakultetit të Drejtësisë pranë shkollës

së Avokatisë, një provim hyrës dhe një provim dalës për të marrë licencën dhe për të ushtruar profesionin e avokatit. I njëjti realitet do të jetë nesër edhe me noterët, me përmbaruesit e të tjerë.

Po jua them të gjitha këto, sepse nuk dua që ky diskutim të merrej me përmbajtjen që ka projektisma për provimin e profesionit të juristit, sepse ky, siç ju thashë, është një draft fillestar i punuar nga komisioni i ekspertëve. Ne, pa diskutim, e kemi nënshkruar. Unë kam qenë nismëtare për ta futur në kalendarin e punimeve të Kuvendit, por, para se të shkojmë te përmbajtja, nëse të gjithë bashkë do të ulëshim ta shikonim, do të kishte nevojë për përmirësime të mëtejshme. Është shumë e rëndësishme që ne të diskutojmë në fillim, të kemi një ide të qartë nëse është domosdoshmëri për ta pasur këtë nismë ligjore apo duhet ta ripjekim edhe një herë të gjithë së bashku këtë mendim, duke iu referuar të gjithë revolucionit që ka kuadri ligjor përkatës për profesionet e lira.

Unë iu referova dy ligjeve më parë, ligjit për arsimin e lartë, për të cilin ju jeni më kompetentë se unë, sepse e zbatoni çdo ditë, të paktën flas për ata që vijnë nga bota akademike. Në botëkuptimin tim kjo çështje që na pengon ta bëjmë këtë diskutim, thjesht na ndihmon të komunikojmë dhe të hyjmë më thellë në detaje. Ligji tjetër, për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë, rregullon, për shembull, profesionin e mjekut, stomatologut, farmacistit, inxhinierit. Nëse i marrim për analogji me profesionin e juristit, nëse do të bëhet gjyqtar, noter apo avokat, nuk do t'i duhet të bëjë provim tjetër përveç provimit të shkollës. Ndërkohë, në rastin e juristëve ne kemi tashmë provime në fusha të ndryshme. Gjithsesi, mendimet tuaja vlejnë shumë më shumë se mendimet tona. Ne jemi këtu për të adresuar shqetësimet që ju keni dhe për t'i kthyer ato në nisma ligjore, sa të jetë e mundur, por duhet ta mendojmë edhe në kuadrin e barazisë së shtetasve para ligjit, sepse një koment që kam lexuar nga grupet e interesit është: pse një mjek e ka kaluarin e provimeve më pak se një jurist, i cili nesër mund të punojë në administratën shtetërore? Pra, në këtë drejtim po e marr si shembull. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh faktin që ky projektligj ka rregulla në përmbajtje të tij se cili e organizon provimin, cila është kategoria e juristëve që duhet të hyjnë në këtë provim, cilat janë kriteret e organizimit të provimit, cilat janë pikët që e kualifikojnë dhe çfarë ndodh në jetë me personin që e merr provimin ose çfarë ndodh me atë që nuk e merr, mendoj se më mirë të fokusohemi te fakti sa e rëndësishme është një iniciativë e tillë, çfarë duhet të bëjmë më mirë, çfarë duhet të kemi në konsideratë, sesa t'i hyjmë përmbajtjes, sepse, nëse ulemi të gjithë bashkë të merremi me përmbajtjen, do të na duhet më shumë se një javë punë për një produkt final. Le të fokusohemi te pika e parë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zonja Bushka ngriti dy probleme.

E para, sa është numri i provimeve që jep sot një student i Fakultetit të Drejtësisë?

Në mos gaboj, ju jeni të gjithë ekspertë, por një provim e jep kur mbaron *Bachelor*-in.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, i nënshtrohet një testi. Më pas ka një test tjetër kur mbaron masterin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, sepse ndaj i kemi ftuar këta.

Gjithsesi, për këtë jemi mbledhur në tryezë sot.

E dyta, si qëndron ligji për provimin e shtetit në kostumin e edukimit juridik që kemi në Republikën e Shqipërisë nga pikëpamja kushtetuese dhe nga pikëpamja ligjore?

Ndaj jemi thirrur në këtë tryezë, pa i hyrë thelbit dhe përmbajtjes së projektligjit. Për thelbin dhe përmbajtjen, nëse projektligji do të ndjekë rrugën normale të diskutimit dhe shqyrtimit në Komisionin e Ligjeve e më pas në Kuvend, ekspertët janë të mjaftueshëm për t'i bërë përmirësimet e duhura. Debatit sot është në parim dhe unë e konsideroj të hapur diskutimin dhe fjalën e ka kërkuar dekani i Fakultetit të Drejtësisë, profesor Artan Hoxha.

Fjala është për ju, profesor, për të dhënë disa opinione dhe konsiderata për ligjin për provimin e juristit.

Artan Hoxha – Faleminderit, zoti Manja!

Ju falënderojmë që na keni thirrur në këtë konsultim publik për një projektligj të rëndësishëm!

Unë kam qenë një nga pjesëmarrësit e reformës në arsimin e lartë dhe po ashtu, edhe në reformën në drejtësi. E njoh historikun e zhvillimit të të gjitha diskutimeve dhe miratimeve përfundimtare që janë bërë për atë që kanë përfunduar. Këtu është edhe zëvendësministri, që është një nga anëtarët e grupit të punës për hartimin e ligjit për arsimin e lartë. Në fillim dua të jap disa konstatime të karakterit parimor.

E para, në reformën e arsimit të lartë, grupi i punës, me të gjitha konsultimet publike që ka bërë, siç bën edhe sot, në asnjë nga variantet e tij dhe në variantin përfundimtar nuk ka propozuar provim shteti për juristët. Futja e provimit të shtetit për juristët është bërë nga Kuvendi në komision dhe më pas në seancë plenare. Kjo do të thotë se, kur hartohet një ligj, ata që e hartojnë kanë parasysh të gjithë korpusin ligjor dhe familjen që i përkasim. Më pas propozohet ajo që vlerësohet se qëndron në korpusin ligjor pa krijuar problematik në ndeshje me legjislacionin në fuqi.

Futja e provimit të shtetit në ligjin për arsimin e lartë në minutën e fundit, me një ide të mirë, që ta forcojmë arsimin juridik, për mendimin tim personal është e gabuar, sepse ne nuk i

përkasim familjes gjermane, por një familjeje ndryshe nga familja gjermane, si të gjitha vendet e tjera të Bashkimit Europian.

Për pjesëmarrësit dua të them se ky diskutim është bërë edhe në shkurt të vitit 2017, ku jemi thirrur dhe na është kërkuar mendim. Nuk shikojmë të ketë ndonjë reagim në projekt, por, meqenëse jemi në nivelin parimor, dua të them se i vetmi shtet në Europë, që ka provimin e shtetit për juristët është Gjermania. Diferenca në atë që propozohet është se në Gjermani, provimin e shtetit, që zhvillohet në dy etapa, e bëjnë ata që kanë përfunduar arsimin e lartë juridik, por mund ta bëjnë edhe ata që mund të mos kenë ndjekur fare shkollën e lartë, por në mënyrë autodidakte janë të përgatitur për provimin e shtetit dhe kalimi i dy provimeve të shtetit në Gjermani është i barasvlershëm me diplomën, ku mund të aplikosh për çdo vend të lirë pune në administratë publike, në avokati, në noteri, në gjykatë, në prokurori, pa qenë nevoja të zhvillosh arsim apo kompeticion të mëtejshëm që të futesh në një fushë të caktuar të zbatimit të ligjit.

Ndërkohë, e gjithë pjesa tjetër e familjes europiane, të cilës ne i përkasim, në shumicë absolute, pas arsimit juridik, nëse do të futesh në fusha të caktuara të aplikimit të ligjit, zhvillon shkolla të caktuara, sikurse ne kemi përcaktuar Shkollën e Magjistraturës për gjyqtarët dhe prokurorët, Shkollën e Avokatisë për avokatët, Shkollën e Noterisë, që është në projekt për noterët, për ndërmjetësit publikë e me radhë. Kjo do të thotë se ne, edhe me projektet që unë kam parë së fundi, që i ka kaluar apo i ka në diskutim Kuvendi i Shqipërisë, ne kemi vazhduar të ruajmë të njëjtën traditë. Pra, vazhdojmë të ruajmë Shkollën e Magjistraturës, Shkollën e Avokatisë e me radhë. Nëse ne do t'i ruajmë këto, provimi i shtetit është një shtesë e padrejtë dhe e pandershme për studentët tanë. Me ligjin për arsimin e lartë nuk të jep diplomë provimi i shtetit, por e jep universiteti ku ke përfunduar studimet e larta. Këtu, vetëm me një futje të një fund fjalie të nenit 82 të ligjit për arsimin e lartë, është prishur e gjithë struktura e ligjit për arsimin e lartë dhe duket sikur diplomën do ta japë një komision, siç propozohet, me noterë e me përmbarues, që nuk shkon fare, është në nivelin qesharak.

Është i vërtetë fakti që ne kemi problematika në arsim, por pyetja që ngrihet është: cili është targetgrupi i reformës? Janë studentët? Ne do të reformojmë studentët apo do të reformojmë vetveten? Nëse do të reformojmë vetveten, nuk kemi pse t'u shtojmë një barrë studentëve. Atëherë, reforma është ndaj institucioneve të arsimit publik ose privat dhe garantojmë që studentët tanë janë të aftë të dalin në tregun e punës. Po cili do ta përcaktojë nesër nëse studenti është i aftë apo jo? Do ta përcaktojë një komision që nuk ka lidhje me arsimin? Ose do të marrim modelin gjerman, siç është, ose do të mbajmë modelin që kemi, që e kemi ndërtuar në kuadrin e reformës në përgjithësi, ta forcojmë edhe me reformën aktuale në

drejtësi, por me dy modele të gërshetuara në mënyrë mekanike dhe jo në mënyrë integrale, do të thotë se një student i juridikut të dalë në punë kur të ketë mbushur moshën 30 vjeç.

Për atë që nisët ju të thoshit ju, zoti kryetar i komisionit, po jua jap unë fazat që kalon një student te ne, përveç provimeve. Përfundimi i ciklit të studimeve Bachelor është faza e parë. Faza e dytë është masteri. Faza e tretë do të jetë nëse do ta bëjmë me provim shteti dhe më pas, nëse do të shkonte në avokat, do të kishte 1 vit stazh pranë një avokati, do të kishte trajnimin fillestar në Shkollën e Avokatisë, do të kishte provimin e kualifikimit dhe më pas burokracinë e licencimit si avokat. Kjo është edhe po të shkosh në fusha të tjera, edhe po të shkosh në administratën publike.

Çfarë qëllimi kemi ne? Kemi qëllim të nxjerrim juristë apo t'u vështirësojmë juristëve në vitet e ardhshme futjen e tyre në tregun e punës.

Unë personalisht jam kundër provimit të shtetit për juristët. Zgjidhja në këtë rast do të ishte: pjesa e dispozitës së nenit 82, të ligjit "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", që është futur jashtë propozimit që ka bërë Ministria e Arsimit me specialistët që u morën 2 vjet me reformën e arsimit të lartë, të shfuqizohet dhe të lihet në fuqi korpusi ligjor që ne kemi dhe të funksionojnë normalisht, në mënyrë që të mos jetë e nevojshme që të vëmë në diskutim Shkollën e Magjistraturës, Shkollën Avokatisë apo shkollat e tjera të profesioneve të lira, sepse nuk kemi pse t'i vendosim, pasi këtë model kemi zgjedhur. Përderisa e kemi zgjedhur këtë model, do të ecim me këtë model. Në qoftë se do të fusim modelin gjerman në mes të këtij modeli, e vetmja gjë që do të bëjmë është se do të vështirësojmë daljen në jetë të studentëve kur të mbarojnë universitetin. Një student, i cili mbaron universitetin për t'u bërë avokat duhet t'u afrohet të tridhjetave, pas gjithë këtyre kalvarëve, sepse janë shumë provime, provimi parë, provimi i dytë, provimi i tretë, dhe në rast se nuk e merr provimin nuk kualifikohet fare.

Unë i kam thënë këto mendime edhe para një viti, por edhe shumë prej nesh, një pjesë e të cilëve janë këtu, i kemi thënë këto gjëra, kur bëmë një konsultë publike me komisionin.

Unë mendoj se nuk është nevoja për këtë projektligj dhe më duket shumë e ekzagjeruar që të krijojmë struktura pa fund sikur buxheti i Shqipërisë të ishte një buxhet i pasur për të krijuar godina, organizma, sekretariate, administrata dhe fonde buxhetore. Për çfarë? Për një provim, që në projektligj thuhet se është një provim *soft*. Meqenëse provimi është *soft*, ai kalkullohet në një mënyrë të tillë, që vetëm *soft* nuk mund të jetë. Kështu që, përfundimisht, qëndrimi im personal, si ekspert i të dyja fushave, është: nuk është nevoja për këtë projektligj, sepse reforma do të shikohet në ecuri. Unë mendoj se reforma e madhe, që është zhvilluar, mund të rregullohet gjatë rrugës.

Unë mendoj se të gjitha shkollat, pas përfundimit të universitetit, siç janë administratat publike, siç janë profesionet e lira, siç është magjistratura, janë të mjaftueshme për të seleksionuar ata që mund të punojnë si juristë nesër në Shqipëri.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, profesor Hoxha, për opinionet tuaja!

Në fakt, projektligji nuk është shumë *soft*, po t'i referohesh nenit 29/5.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 29, pika 5, e këtij projektligji e bën shumë më të fortë sa ç' duhet dhe jo *soft*, por qëllimi është *soft*.

Kush e do fjalën.

Po zonja Hysi, meqenëse keni qenë edhe relatore e dy ligjeve.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, të nderuar kolegë, për pjesëmarrjen në këtë takim!

Unë kam pasur mundësinë të njihem më shumë nga ligjet e reformës në drejtësi dhe me ligjin e arsimit të lartë, pasi kam qenë relatore e ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Është e vërtetë ajo që tha kolegu Hoxha, që në projektligjin e sjellë nga qeveria për arsimin të lartë nuk ka pasur një dispozitë të veçantë për provimin e shtetit për profesionin e juristit. Zoti Kola mund ta konfirmojë këtë gjë, meqenëse ka punuar në grupin e punës për mendimin. Në momentin që ka ardhur projektligji sapo ishte botuar Analiza e Sistemit të Drejtësisë dhe plani i veprimit nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë të reformës në drejtësi. Propozimi ka ardhur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë të reformës në drejtësi për të bërë amendimin e ligjit, për të shtuar një dispozitë lidhur me ligjin “Për provimin e shtetit për profesionin e juristit”. Atë grup e ka drejtuar zonja Aurela Anastasi. Ne këtu kemi dy kolege të nderuara, profesoreshë Marjana Seminin dhe profesoreshë Arta Mandro, të cilat kanë qenë pjesë e grupit të punës. Amendamenti në ligjin e arsimit të lartë është bërë me kërkesë të ekspertëve të nivelit të lartë, të cilët kanë sjellë një kërkesë për riformulimin e nenit, në mbështetje edhe të propozimit të ekspertëve të EURALIUS-it.

Së dyti, unë kam qenë relatore e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjit “Për qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe në të dyja këto ligje të reformës në drejtësi ne e kemi përmendur ligjin “Për provimin e shtetit dhe profesionin e juristit”.

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj nenin 28, germa “c”, “Kriteret e pranimit të formimit fillestar” të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku thuhet: “Pranohen si kandidatë në Shkollën e Magjistraturës studentët që kanë

përfunduar me pikët minimale, të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, ciklin e dytë të studimeve, si dhe ka dhënë provimin e shtetit”.

Gjithashtu, në nenin 170 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2 thuhet: “ Kriteret për kalimin e provimit të shtetit do të zbatohen për magjistratët kandidatë, të cilët kandidojnë për programin në Shkollën e Magjistraturës, pas hyrjes në fuqi të ligjit që rregullon kriteret dhe procedurat e pranimit të provimit të shtetit”.

Në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, meqenëse nuk kemi një ligj të posaçëm për Shkollën e Magjistraturës, sepse ligji që ka pas rregulluar organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës është përfshirë në ligjin e organeve të qeverisjes, nga neni 266 e në vijim janë përcaktuar rregullat se si do të pranohen studentët kandidatë në Shkollën e Magjistraturës.

Për transparencë, këtu kam zonjë Agnes, e cila e ka ndjekur nga afër të gjithë procesin, ka qenë edhe zoti Riçard, por ai ka kaluar ekspert për OMN-në, dhe është diskutuar ose argumenti për futjen e provimit të shtetit ka qenë që të unifikonim standardet, meqenëse kishte shumë universitete jopublike, kishte një inflacion të diplomave dhe na rezultuan skandale në një sërë universitetesh, që tashmë janë mbyllur, por në kohën kur u bë ligji i provimit të shtetit dhe ligji statusit këto universitete funksiononin, prodhonin diploma dhe i shisnin ato. Pra, në atë kohë këto universitete nuk kanë qenë të mbyllura dhe nga ekspertët e nivelit të lartë u argumentua se duhet të kishte një filter .

Së dyti, kolegu Haxhia ka drejtuar grupin e ekspertëve të nivelit të lartë që do të merrej me profesionet ligjore dhe mund të na thotë që ne kemi pasur edhe paketën e ligjeve që rregullonte profesionet ligjore, si: avokatinë, noterinë, ndërmjetësimin, ligjin për përmbaruesin gjyqësor. Në atë kohë u sugjerua se në këtë paketë ligjesh, ku do të rregullohej statusi që do të kishin provimet e këtyre institucioneve, nëse do të kishte provime hyrëse për t’u bërë avokat apo nëse do të mjaftonte provimi i shtetit. Nëse do të ishte vetëm provimi i shtetit, mund të shikohej mundësia, meqenëse ligji i avokatisë ishte në diskutim dhe është ende në diskutim, se çfarë natyre do të kishte, sepse provim hyrës nuk mund të ishte njëlloj si provimi i shtetit. Meqenëse ligji i noterisë është në proces diskutimi, provimi hyrës për noterinë do të jetë si një specializim apo si një provim shteti, me të gjitha standardet, kriteret dhe modelin që do të kishte ky provim.

Prandaj, të nderuar kolegë, mos harroni që ne kemi në dorë një paketë projektligjesh, që nuk kanë kaluar ende, si ligjin e avokatisë, ligjin e noterisë, ligjin e përmbaruesve, kemi strategjinë dhe planin e veprimit të edukimit ligjor e të tjerë. Kjo kërkesë, megjithëse këtu mund të flasin edhe profesoret Mandro dhe Semini, ka ardhur nga grupi i ekspertëve vendas dhe

ndërkombëtarë. Pra, nuk ka qenë një lajthitje imja, si propozuese e amendimit të ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, por ishte një kërkesë me detyrim për të reflektuar reformën në drejtësi.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Haxhia e ka kërkuar fjalën, kryetari Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Maksim Haxhia – Faleminderit, zoti kryetar!

Natyrisht, ne nuk jemi mbledhur këtu për të kërkuar informacion dhe llogari se kush e ka propozuar. Unë çmoj se ne jemi thirrur këtu për të diskutuar nëse është i nevojshëm kalimi i një ligji të tillë, pse është i nevojshëm dhe çfarë problemesh zgjidh, qofshin këto probleme të nivelit të njohurive profesionale, qofshin probleme të nivelit të përvetësimit të fushave, ku do të ushtrojnë profesionin gjyqtarët, prokurorët, avokatët, noterët, përmbaruesit apo ndërmjetësit, por edhe probleme sociale.

Unë po e nis fjalën time edhe si profesionist, edhe si anëtar i komisionit të ekspertëve, por edhe si prind, pa thënë: “Ne ishim, ata ishin”, sepse kjo nuk ka rëndësi. Pse duhet ta mbaj unë fëmijën tim 29 vjet me të ardhurat e mia?! Po mirë unë e mbaj, se i kam mundësitë, po një tjetër, që nuk ka mundësi, si do ta mbajë?! Ne nuk jemi një shoqëri që mund t’i sigurojmë çdo individ, pas moshës 18 vjeç, të ardhura minimale. Ky problem social shoqërohet edhe me një pretendim, që kanë të drejtë ta ngrenë të rinjtë, sepse mund të na thonë: “Ju i bëni këto ligje, sepse nuk jeni të aftë që të na punësoni dhe kështu rrisni kohën e punësimit, duke na vendosur pengesa të tilla”. Në qoftë se është kështu, atëherë unë po nisem nga një problem tjetër: çdo ligj që do të miratohet duhet të kapet te qëllimi.

Në nenin 5 thuhet: “Qëllimi i provimit të shtetit është garantimi i standardit minimal të njohurive”. Atëherë që këtu ky ligj nuk duhet të diskutohet fare, sepse ose do të pranojmë që universitetet tona janë skandal dhe nuk kanë prodhim cilësor, ose do të themi se ky ligj bëhet thjesht për të mbushur një kërkesë, sa për të thënë se po bëjmë një reformë. Nuk dua t’u futem atyre që tha zoti Hoxha, që këtu është një eksperiencë gjermane dhe që është e vlefshme vetëm për në Gjermani. Pse? Sepse është futur në një hallkë zinxhiri, ku janë të gjitha sistemet e tjera dhe institutet e tjera brenda, qoftë në harmoni me ligjin “Për arsimin e lartë”, qoftë në harmoni edhe me profesionin e juristit, por kjo mund të dalë edhe për profesionet e tjera.

Problemi tjetër: është e vërtetë që ne kemi diskutuar këtë problem, por jo në këtë këndvështrim. Ne kemi diskutuar, sepse politika i ka shkaktuar një dëm të madh kësaj shoqërie duke licencuar pa kriter dhe duke bërë ligje, që nuk siguronin cilësinë e mësimdhënies në universitetet tona të larta, duke krijuar universitete nga njerëz që nuk kanë pasur jo vetëm njohuritë, jo vetëm dëshirën, por as preokupacionin dhe dhembshurinë për të nxjerrë

profesionistë të fushës. Atëherë, ky licencim i madh ka sjellë ngritjen e shumë universiteteve private, në mos gaboj janë 17 në fushën e drejtësisë. Më mirëkuptoni, unë nuk jam kundër universiteteve private, por jam kundër shitjes dhe nxjerrjes së kolegëve me diploma të pamerituara. Unë jam për një cilësi të lartë, në mënyrë që tregu i punës të ketë profesionistë të nivelit të lartë. Atëherë, duke u krijuar një numër i tillë universitetesh, shtetin shqiptar e pa Zoti që t'i kontrollonte dhe ne kemi qenë dakord për të krijuar një qendër kombëtare të korrigjimeve, jo një qendër kombëtare licencimesh. Absolutisht jo! Pra, qendër kombëtare, që të kontrollonte jo vetëm provimet e lëndëve, por të kontrollonte provimin e fundit të çdo universitet. Kjo qendër kombëtare, duke bërë edhe korrigjimet e provimit të fundit, bënte edhe listimin vjetor të niveleve të universiteteve, siç e ka gjithë bota, dhe thoshte (po marr "Luarasin" ose UET-në, pa dashur të bëj reklamë): "Kjo e para, kjo e dyta, kjo e treta" dhe prindërit ose studentët, që ishin kandidatë për t'u anëtarësuar në një universitet, shinin listimet dhe thoshin: "Po, vit pas viti ky është në *top list*" dhe shkonte tek *top list*-a. Vit pas viti, shteti shihte nivelet e ulëta. Në qoftë se një universitet qëndronte në kategori nivelesh të ulëta, shteti i hiqte licencën. Ky ishte gjithë qëllimi që ne kemi diskutuar.

Pra, unë them se ky ligj, pa dashur të fyej eksperiencën gjermane, nuk ka të bëjë fare me eksperiencën tonë.

Nëse do të pranojmë eksperiencën gjermane, do të bëjmë një përmbysje totale. Po e pranuar, do të heqim avokatinë, Shkollën e Magjistraturës, përmbarrimin, të gjitha dhe do të mjaftohemi tek ai nivel...

Por ky thotë: "Nivel minimalist". Atëherë, si mund të heq një sistem ku kam investuar gjithë këto vite?! Sepse kështu na keni thënë: "Do të marrim një praktikë të konsoliduar". Sa më shumë hallka të sistemeve të ndryshme të fusim në një sistem, aq më i çoroditur bëhet ai.

Prandaj, jam kundër që në parim, qoftë nga pikëpamja e cilësisë, nga qëllimi, nga cilësia, nga organizimi, qoftë edhe nga pikëpamja sociale. Do t'i rëndojmë familjet...

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

Po, zonjë, mund të prezantoheni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Metani...

Artur Metani – Përshëndetje!

Unë jam Artur Metani, drejtor juridik në Kryeministri.

Duke ndjekur diskutimet e dy parafolësve, të kolegëve Hoxha dhe Haxhia, unë them se nxirret në pah defekti kryesor që kemi në procesin ligjbërës në Shqipëri, që nuk bëhet një analizë e hollësishme, ligjore, politike, sociale, ekonomike, e të gjitha sferave, që prekin

propozimet ligjore dhe vijmë në rastet ku janë bërë ndryshimet në ligjin për arsimin e lartë (si ky që flasim), pa u bërë një analizë e mirëfilltë, duke pasur parasysh edhe sugjerimet e dy kolegëve parafolës. Pastaj vijmë te ligjet, që janë miratuar për reformën në drejtësi, pa bërë një analizë se çfarë rregullojmë me ato që propozojmë.

Duke parë edhe relacionin, që shoqëron projektligjin, që është vetëm një paragraf, dy janë arsytet pse kërkojmë miratimin e këtij ligji:

E para, cilësia e dobët e universiteteve private dhe joshtetërore.

E dyta, literatura e varfër juridike, debati, mungesa e familjarizimit me të drejtën ndërkombëtare e kështu me radhë...

Unë s'e kuptoj se si do ta zgjidhi provimi i shtetit këtë hall që kemi, se do të bësh provime çdo vit dhe ti këtë hall do të kesh, në vend që të fillojmë nga halli!

Ti tani ke bërë një ligj për arsimin e lartë. Ka dy vjet që ne nuk kemi një analizë, as ministria respektive s'ka bërë një analizë: a ka pasur efekt ky ligj? Në qoftë se nuk ka pasur efekt, atëherë të marrim masa të tjera, para se të kalojmë te ky ligj.

A ka efekte financiare ky ligj që propozohet?

Çfarë do t'i sjellë shoqërisë?

Do të ketë efekt në tregun e punës?

Ka probleme konkurrenca?

Domethënë, përpara se të diskutojmë ligjërisht për gjënë, duhet të shohim një herë arsyen përse na solli këtu.

Unë nuk e shoh, te relacioni jo, por edhe nga diskutimet, dhe më vjen mirë që edhe zoti Hoxha edhe zoti Haxhia, janë në këtë linjë, sepse, natyrisht, në këtë linjë duhet të ishin, sepse janë juristë me përvojë...

Për të mos u hyrë pastaj edhe problemeve ligjore, që neni 82 nuk parashikon fare miratimin e një ligji për këtë proces, sepse ia ngarkon procedurën Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Drejtësisë. Ne tani ngremë disa struktura (s'po e them fjalën) të panevojshme për momentin, pa i analizuar.

Nuk po i hyjmë teknikës legislative, sepse, sigurisht, e tha edhe deputetja, ky është një projekt fillestar dhe ka shumë probleme, që nga neni 7, që parashikon përjashtimin nga konkurrimi për ata që kryejnë vepra penale. Ndërkohë, ligji për garantimin e figurës së deputetit i ka përjashtuar ata nga disa vepra penale.

Tani, ose do të jemi... Prandaj është e nevojshme, që kur propozohen ligjet, propozimet të bëhen nga një dorë profesionistësh dhe jo se propozohet nga një deputet apo nga një grup deputetësh, qofshin këta edhe të mbështetur nga ekspertë të një niveli të caktuar, sepse mund të jesh ekspert në nivel të caktuar, për një çështje të caktuar, por kodifikimi i legjislacionit është

një proces që jo të gjithë dinë ta bëjnë, sidomos procesin e ligjbërës. Ky është një proces, që ka të bëjë jo vetëm me këtë ligj, por me të gjithë procesin ligjbërës këtu në Kuvend. Ky është problem parimor.

Në qoftë se do të flasim për gjëra teknike, kam edhe gjëra të tjera, por kjo ishte sa për t'ju dhënë një ide.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Metani!

Zonja Konomi ka kërkuar fjalën .

Rezana Konomi – Rezana Konomi, universiteti “Luarasi”.

Në fakt, për këtë projektligj jemi mbledhur dhe kemi diskutuar edhe një herë tjetër dhe pak a shumë kemi rakorduar në të njëjtin mendim për sa i përket vlefshmërisë, duhej apo s'duhej.

Por në qoftë se pyetjes “duhej apo s'duhej” i është dhënë një gjysmë përgjigje, pasi është parashikuar që për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit të kalohet në provim shteti, tani po diskutojmë nëse do të jetë ose nuk do të jetë për profesionet e tjera, që përjashtohen nga të qenurit gjyqtar dhe prokuror. Gjysma e përgjigjes është dhënë, që duhet, sepse e dikton vetë ligji për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit, që duhet të kalosh në provimin e shtetit. Jemi duke diskutuar tashmë vetëm për një kategori tjetër, që, në njëfarë mënyre, duhet apo s'duhet, do t'i vendosë ose në kushte diskriminuese, të pabarabarta, ose jemi duke diskutuar vetëm për këta, sepse për të përfituar statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit, duhet të kalosh në provimin e shtetit, sepse është pasqyruar në ligj. Kjo është e para.

E dyta, kur është diskutuar nevoja e këtij projekti (ishte momenti kur diskutohej reforma dhe se sa do të afektonte ajo te pjesa e arsimit të lartë ose e kundërta), një nga qëllimet ishte që, e para, të unifikoheshin diplomat, të cilat nuk kishin vlerë të njëjtë në tregun e punës (megjithëse nuk kemi statistikë dhe studime se sa është e vlefshme dhe cila është e vlefshme, por e lëmë mënjane këtë) dhe, në relacion, po ta shikosh, thuhet se nuk kishte mbaruar procesi i akreditimit të cilësisë së universitete. Kjo do të thotë se ky relacion përkon në kohë me një vit më parë, kur është diskutuar për herë të parë projektligji (dy ose tre vjet, nuk e di se kur). Kjo do të thotë se sot ky proces ka përfunduar. Megjithëse ka përfunduar, unë përsëri shtroj pyetjen: sa vlerë ka ky proces akreditimi?

Nuk di që Ministria e Arsimit të ketë bërë ndonjë studim mbas këtij procesi, se çfarë ka ndodhur dhe si ishte procesi, pavarësisht se u akordua nga një agjenci britanike e atashuar pranë Ministrisë së Arsimit.

Gjithsesi, ky proces akreditimi ka përfunduar dhe në njëfarë mënyre, ka vendosur jo rankim, sepse nuk është rankim, atë që tha edhe zoti Maksi, por ka një lloj certifikimi, për sa i

përket cilësisë dhe vlefshmërisë së diplomave. Pra, nuk e di nëse procesi i akreditimit është ose jo i saktë, por ka përfunduar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, rankim nuk është. Rankim nuk ka.

Ndërkohë procesi i akreditimit ka përfunduar.

Fakti që ky projektligj duhet të diskutohej, sepse arsimi i lartë nuk figuron të jetë konkurrues në tregun europian, fakti se do të ketë një standard minimal, e siguron për të qenë konkurrues në tregun europian, domethënë, a e përligj qëllimin? Nuk e përligj.

Për më tepër, kush na garanton ne që ky komision, që do të ketë gjithë këtë procedurë ekstra, shumë të zgjatur, ose struktura apo superstruktura, që do të ngrihen në funksion të këtij ligji, do të jetë vërtet ai, që do të na sigurojë cilësinë dhe garancinë? Ndërkohë, sa herë kemi shtuar hallka, aq më shumë kemi ngushtuar hinkën dhe aq më shumë kemi shtuar riskun për të rritur abuzimin dhe korrupsionin.

Kështu që nuk besoj se qëllimi, për të cilin është diskutuar fillimisht, mund të përligjet sot në këto kushte që jemi, krejt të ndryshme nga momenti fillestar.

Ulsi Manja –Faleminderit, zonja Konomi!

Po, zonjë, ju lutem!

Kestrin Katro – Kestrin Katro, zëvendësdekane e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Një nga çështjet kryesore, që ngriti deputetja Hysi dhe shqetësimet kryesore, për të cilat është futur provimi i shtetit në të gjitha ligjet që përmendi, ishte edhe zgjidhja e diversitetit, që kanë programet e fakulteteve të ndryshme të drejtësisë.

Në fakt, sot ligji për arsimin e lartë e ka tejkaluar këtë gjë, sepse është parashikuar me ligj që 70% e programit do të jetë uniform në të gjitha programet e drejtësisë, pra është tejkaluar një shqetësim i tillë, prandaj është e tepërt të jetë një nga bazat mbështetëse të hartimit të një ligji të tillë. Për më tepër, sot, e thanë edhe kolegët, është një kalvar shumë i gjatë për juristin, që të quhet “jurist” në drejtimin që ai zgjedh. Shkollë, shkollë, shkollë dhe vetëm shkollë... Ligji vetë ka një ngarkesë të tejskajshme për një standard minimal.

Unë nuk e kuptoj se ç’do të quhej “standard i lartë”, në qoftë se ky është standardi minimal, me këshill të veçantë, me zyra mbështetëse, të cilat nuk kanë përcaktuar as formacionin që do të kenë?! Burokracitë janë të përcaktuara fare mirë në ligj, të tjerat pastaj...

Për më tepër, në ligj vihet re një gjë shumë shqetësuese: gjithë korpusi akademik përjashtohet nga çdo gjë që ka lidhje me provimin e shtetit, domethënë, akademikët të mos qasen fare, as në këshill dhe as tek testuesit. Akademikët janë absolutisht të përjashtuar nga ky

ligj dhe kjo është shqetësuese, sepse ku do të gjesh personel më të përgatitur, më të kualifikuar, me tituj, me garda shkencore se në korpusin akademik?! Ky është një tjetër shqetësim.

Prandaj, jam me mendimin e shumë parafolësve, që ligji, në fakt, nuk duhet të qëndrojë, dhe nëse merret vendimi se duhet të qëndrojë, duhet të përshtatet pikërisht me atë që parashikon neni 5: standardin minimal.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Katro!

Fjalën e ka zonja Peto.

Zhaklina Peto – Faleminderit për ftesën!

Ashtu sikurse komentuan edhe më parë kolegët, ne kemi qenë një herë pjesë e këtyre diskutimeve në vitin 2017 dhe e kemi kundërshtuar fort ekzistencën e këtij ligji, për të gjitha arsytet që u diskutuan këtu, por mbi të gjitha, të paktën unë, kam pasur qëndrimin social, atë që profesor Haxhia përmendi, se kur do t'i bëjmë të aftë studentët, që mbarojnë shkollën, të krijojnë të ardhurat e tyre dhe të realizojnë edhe politikatat e punësimit, Kodin e Punës, pra të shkojnë në një harmoni, në mënyrë që studentët të shkojnë drejt tregut të punës dhe jo drejt rrugëve të tjera?

Gjithashtu, në këtë ligj është harruar të evidentohet, megjithëse ne e kemi thënë edhe në takimet e tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është reflektuar, por nuk ka rëndësi.

Komentet që janë bërë në lidhje me riorganizimin e strukturës universitare... Fakulteti Juridik, atë që sapo tha Kestrina, po shkon me 70% në unifikimin e programeve, por, nga ana tjetër, po shkon në 5-vjeçar, me një diplomë të integruar të nivelit të dytë.

Gjithashtu, në ligjin për arsimin e lartë, përveç diplomës së integruar të nivelit të dytë, ku studenti do të japë 35 provime, që janë më se të mjaftueshme, dhe unë mendoj se 35 provime, që jep studenti i Fakultetit të Drejtësisë, nuk janë standard minimal, sepse në kurrikulën e re, këto provime janë më shumë se një standard minimal, janë ato që të bëjnë të aftë për të dhënë provimin e Shkollës së Magjistraturës më pas, pra deri diku janë njohuri të thelluara, sepse që të marrësh provimin e Shkollës së Magjistraturës, njohuritë duhet të jenë shumë të thelluara në fushën e drejtësisë, dhe për aq kohë sa studentët tanë shkojnë në Shkollën e Magjistraturës, do të thotë se kanë marrë njohuri të thelluara në fakultete. Pra, kjo bie ndesh edhe me nenin 5 të këtij ligji.

Unë mendoj se, gjithashtu, masteri ekzekutiv, një element i ri i përfshirë në ligjin për arsimin e lartë, le të themi se është një kualifikim tjetër shumë i rëndësishëm, i cili zerohet fare me ekzistencën e provimit të shtetit. Pra, mund të marrësh diplomën e integruar të nivelit të dytë, të vazhdosh masterin ekzekutiv, të duash të vazhdosh predoktoraturë, që është para

doktoraturës, duhet të japësh patjetër provimin e shtetit më pas për t’u bërë jurist, sepse edhe ky master, që është shkencor i mirëfilltë, të zerohet fare dhe ti nuk ke ku të shkosh. Nga ana tjetër, më bëri përshtypje ajo që sapo tha Kestrina, kur lexova projektligjin, të cilit iu referova, të kesh një urrejtje për pedagogët, më falni që po e them kështu, të mos e përfshish fare pedagogun e Fakultetit të Drejtësisë...! Ne kemi nga 23 vjet pedagogë, të përfshihen përmbartuesit që janë studentët tanë, kjo është fyerje për fushën e akademisë, prandaj do t’ju thosha se disa gjëra duhet t’i rishikoni. Ajo çka është më e rëndësishme në këtë ligj është se nuk kuptohet nëse do të jepet një provim përfundimtar, pra një provim profesioni apo tre. Pse?

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk ka rëndësi, vetëm kaq...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, është një provim apo janë tre provime, sepse edhe kjo është...

Në parim jam kundër këtij ligji, sepse ky ligj shton kalvarin dhe rëndon jetën e familjeve shqiptare, mbi të gjitha sjell një problem social shumë të madh te ne dhe nga ana tjetër, ky provim injoron ekzistencën e bazës, Fakultetin Juridik.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Peto!

Fjalën e ka kërkuar profesoreshë Mandro.

Ju lutem, zonja Mandro!

Arta Mandro – Ju falënderoj për ftesën dhe për fjalën!

Dua t’ju bëj vetëm një saktësim të vogël. Në fakt, unë kam qenë pjesë e këtij grupi me cilësinë e *think tank*-ut, në kuptimin që së bashku me ekspertë të tjerë të botës akademike na është vënë në dispozicion ligji dhe kemi komentuar mbi të. Sikurse kjo tryezë sot, edhe ne kemi pasur pro-të dhe kundër-at ndaj një ligji të tillë.

I mirëkuptoj të gjithë kolegët, por dua ta trajtoj pak çështjen në parim, sikurse dua të mirëkuptoj edhe veten time njëherazi, si një njeri që ka dhënë një kontribut për një periudhë të caktuar në arsimin juridik shqiptar. Mendoj se mund të bëjmë analiza përtej vetes sonë, kualiteteve që kemi si pedagogë dhe përtej institucionit në të cilin ne japim kontributin tonë. Kjo analizë shkon drejt asaj fjalës kyçe, mua më pëlqen ta them, interesi i fortë publik. Çdo ligj që ne diskutojmë dhe miratojmë në fund fare duhet të shoqërohet nga parimi i interesit të fortë publik, çka do të thotë që a e ka ligji në fjalë në brendësinë e vet kontekstin e parimit të interesit të fortë publik? A i përmbush ai standarde dhe kriteret të tilla? Për ta parë këtë gjë ne duhet ta fillojmë nga poshtë me dokumentin e analizës që na u vu në dispozicion në atë moment lidhur me situatën e arsimit juridik në Shqipëri. Pra, kur flasim për arsimin juridik në Shqipëri, nuk jemi duke folur në mënyrë të përveçme, për një fakultet drejtësie që është më i miri, pse të mos

themi dhe i një niveli ekselence, qoftë ky publik apo privat, por jemi duke folur në përgjithësi për produktin e dalë nga tërësia e arsimit juridik në vendin tonë.

Pyetja e dytë, prapë parimore, shumë e rëndësishme, meqenëse po diskutojmë prapë nëse do të qëndrojë apo jo një ligj i tillë, ka të bëjë me balancën e duhur mes vlerës që ka diploma në drejtësi, lëshuar nga fakultetet e drejtësisë si institucione të arsimit të lartë dhe provimit të shtetit. I dëgjova me shumë interes komentet e bëra. Sa realizohet ky interes publik pa e zhvlehtësuar një interes tjetër publik që është pikërisht ai procesi i diplomimit për drejtësi? Kjo është shumë e rëndësishme për t'u pasur në konsideratë, në qoftë se ligji do të merret dhe do të pranohet si i tillë.

A janë sistemet e rekrutimit në profesionet e tjera ligjore, sisteme adekuate, sepse ne duhet të bëjmë edhe një analizë tjetër, se sa i ndihmon ky ligj këto sisteme të rekrutimit. Pse e them këtë? E them këtë se Shkolla e Magjistraturës ka adoptuar sistemin e vet të rekrutimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Sistemet e veta, shumë të personalizuar i kanë implementuar edhe Dhoma e Avokatisë, edhe Noteria, edhe shërbimet e tjera, por a i ndihmon, në kuptimin e një interesi publik ky ligj këto profesione të lira? Pra, si do të ruhet balanca midis diplomës së marrë nga institucione që janë të akredituara, të certifikuara, që kanë cilësinë e duhur nga njëra anë të pedagogëve dhe të studentëve, kundrejt profesioneve të tjera të lira?

Mendoj se në vende si Shqipëria ka pasur një etje të jashtëzakonshme për t'u diplomuar në drejtësi që nga hapja e shkollës së parë, po e quaj private. Me qenë se ushtroj një funksion publik, e kam ndjekur procesin e të diplomuarve vit pas viti, ndërkohë duke qenë pedagogë në Shkollën e Magjistraturës kam pasur mundësi të bëj analiza lidhur me kualitetet, me cilësitë e të diplomuarve në fakultetet e tjera, të cilët nuk arrijnë të dalin me sukses në provimin e Shkollës së Magjistraturës, me përjashtim të studentëve të diplomuar nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës. Pra, mund t'ju them se ka një përqindje shumë të vogël të fakulteteve të tjera private. Ku shkojnë këta të tjerët? Këta shkojnë dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në institucione dhe në profesione të tjera. Pra, mbase duhet një analizë e këtij interesi të fortë publik pa i diskriminuar absolutisht, duke i trajtuar si të barabarta të gjitha diplomat, sepse çështjet e drejtësisë janë delikate dhe nuk janë të lidhura vetëm me mekanizmin e të bërit gjyqtar apo prokuror. I gjithë sistemi i drejtësisë ka të bëjë me mjetet efektive dhe mjetet efektive janë që të rregullohet i gjithë sistemi si pjesë e së tërës.

Pyetja që unë dua ta shtroj edhe një herë, t'ju sjell në vëmendje dhe ta nënvizoj, është: a ka vërtet një interes të fortë publik? A ndihmon ky ligj në përforcimin e interesit publik, duke eliminuar frikën në kuadrin e standardit minimum që thotë ligji, ku pyetjet do të jenë të një standardi minimum? Këtu me shumë të drejtë thuhet: "Diplomimi në Fakultetin e Drejtësisë nuk i ka standardet minimum, ka nivele shumë më larta". Pra, si do të ruhet kjo balancë që, nga

njëra anë, të riparohen defektet e një sistemi që ne vetë e krijuam në kuadrin e ecjes së madhe që të gjithë të bëhen juristë? Ndërkohë kemi kosto të tjera, kosto në profesione të caktuara dhe shteti ka një interes të fortë publik që t'i eliminojë këto kosto. Në qoftë se sot flasim për kostot e një individi dhe për kostot e një familjeje, duhet të mendojmë për kostot e personave të tjerë që shkojnë te juristi, shkojnë tek avokati, shkojnë te përmbaruesi, shkojnë te noteri. Para disa vitesh na është dhënë mundësia së bashku me profesoreshë Marianën të bënim një *research* apo një studim të vendimeve gjyqësore, më falni që po jua them, nuk kam për qëllim të denigroj asnjë profesion, sepse të gjithë janë të domosdoshëm dhe të nderuar, lidhur me impaktin që ka roli i një profesioni të caktuar në vendimmarrje, nuk po e them profesionin. Vumë re që një përqindje e konsiderueshme, që lidhej pikërisht me veprimet e një profesioni të caktuar, kishte afektuar dhënien e vendimit apo cilësinë e jetës së një individi. Pra, si ta shikojmë sistemin si një tërë dhe sa ky ligj pa diskriminuar dhe pa cenuar asnjë të drejtë riparon disa të meta, defekte dhe certifikon këtë interes publik?

Ju faleminderit shumë!

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Mandro!

Fjalën e ka kërkuar për një pyetje, zoti Metani.

Artur Metani – E kuptoj parashtrësën e pedagoges së nderuar dhe e respektoj në fakt, sepse ky është qëllimi, duke rënë dakord me shqetësimin që ju keni.

Kam një pyetje. Është bërë një analizë, çfarë do ta ndryshojë provimin e shtetit nga provimi që bëhet sot në Shkollën e Magjistraturës, i cili bëhet edhe nën një kujdes ndërkombëtar? Çfarë e ndryshon këtë provim nga provimi që bëhet në DAP, për pranimin në administratën publike, si dhe provimet që ndiqen në institucionet e tjera? Cila është ajo vlerë e shtuar që ofron ky provim? A është bërë një analizë e tillë? Pra, mbasi të jetë bërë ta shohim dhe ta...

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Metani!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit, zoti Metani, për pyetjen!

Po, ka një analizë të detajuar, të publikuar, që është pjesë dhe kapitull i veçantë tek analiza e sistemit të drejtësisë. Ka një plan veprimi, i miratuar nga komisioni *ad hoc* i reformës në drejtësi dhe në planin e veprimit është përmendur ligji për provimin e shtetit dhe objektivat, por në atë kohë, prandaj ndërhyra edhe herën e parë, është menduar që ky provim do të jetë provim dalës. Pra, nuk do të ketë shumë provime, do të ketë vetëm një provim. Në radhë të parë, ky provim është për të gjithë ata që kanë 5 vjet shkollë, 300 kredite. E para.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, është, por jo tek ajo.

Është analiza e sistemit të drejtësisë dhe plani i veprimit, sepse propozimi për provimin e shtetit ka ardhur nga komisionerët e reformës në drejtësi dhe jo nga komisioni ku ka punuar zoti Hoxha, për ligjin e arsimit të lartë. E para.

E dyta, debati që është bërë në atë kohë është: kush do ta japë provimin e shtetit? Ne kemi thënë se, meqenëse do të fillojë sistemi 5-vjeçar në vitin 2017, është lënë e hapur vetëm, mund të më korrigjojë Agnesi, periudha në dispozitë kalimtare se për cilën kategori të diplomuarish do të fillojë të aplikohet provimi i shtetit.

E treta, është menduar që profesionet e lira nuk do të kishin provim hyrës, përveç Shkollës së Magjistraturës dhe shërbimit civil. Pra, ndërmjetësuesi, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, nuk do të bënte provim shteti, por do të ishte ky provim i vlefshëm, i standardizuar. Pra, mund të bënin formime vazhduese. Siç edhe jua thashë, ligjet e profesioneve të lira i kemi në dorë dhe nuk i kemi miratuar ende. Gjithashtu, ishte menduar që provimi hyrës në Shkollën e Magjistraturës, i cili ka dy faza, është një provim komplet krejt tjetër, është test psikologjik dhe do të ishte më shumë praktik. Pjesë e këtij diskutimi ka qenë edhe zoti Sadushi, drejtor i Shkollës së Magjistraturës.

Pra, ajo që është kërkuar është që pas 5 vjetësh fakultet të kishte vetëm një provim. Me të drejtë zoti Haxhia tha që të gjitha provimet të kontrolloheshin nga një qendër provimi, por unë nuk jam dakord me përmbytjen që është dhënë në projektligj që në këtë grup të jenë noterë privatë dhe përmbarues, por duhet të jenë profesorë me tituj dhe grada, të cilët dinë ta bëjnë testin dhe ta korrigjojnë. Fakultetet nuk do të bëjnë provime, por do të ishte vetëm ky provim dhe pas tij kush e merrte provimin 1, 2 apo 3 herë, kjo varet nga vullneti politik dhe se si do të përcaktohen, do të konkurronin, por në Magjistraturë do të kishte një filtër. Për profesionet e lira nuk ishte menduar dhe kjo ka qenë logjika në atë kohë, që të kishte prapë provime. Formim vazhdues, pa dyshim që do të kishte gjatë profesionit.

Pra, është menduar një provim dalës dhe asnjë gjë tjetër.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Artur Metani – Pikërisht ne këtë donim në relacion, të gjitha këto të dhëna që ju keni të jenë pjesë e relacionit...

Vasilika Hysi – Keni shumë të drejtë për relacionin...

Artur Metani - .. dhe më pas ne të fillojmë të gjykojmë, por pa pasur asnjë informacion...

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Metani!

Fjalën e ka kërkuar zonja Semini.

Urdhëroni, zonja Semini!

Mariana Semini - Faleminderit, zoti kryetar!

Do ta nis nga një pyetje e momentit: në gjendjen që është ky draft çfarë kostosh sjell për të gjithë? Çfarë interesash cenon dhe çfarë interesash mbron? Ne po e diskutojmë në parim dhe makro. Referuar modelit që kemi përpara, në gjendjen që është dhe në gjendjen që ka qenë edhe para versionit që kemi, ky ligj është kritikuar vazhdimisht në çdo tryezë. Unë mendoj se ka dy elemente të rëndësishme që janë: ideja dhe materializimi i idesë. Ideja nuk doli apriori. Zonja Hysi dhe zoti Haxhiaj e trajtuan në mënyrë shumë koncize dhe ma bënë më të lehtë diskutimin.

Për t'iu përgjigjur shqetësimit të zotit Metani, unë hyj te personat që e vlerësoj si maksimale mundësinë e bërjes së një studimi para se të kalohet në draft. Nga të gjitha sondazhet që u bënë në kohën kur diskutohej nëse do të hidhej kjo ide ose jo, rezultoi që numri i personave që skualifikoheshin në provime të avokatisë ose Shkollës së Magjistraturës ishte i konsiderueshëm. Statistika e fundit që mund të jap, sepse ka kaluar kohë dhe nuk i kam të gjitha shifrat, është që Shkolla e Magjistraturës ka në vit të parë 15 studentë, kur ka 25 vende, kjo do të thotë se 10 vetë nuk arritën dot as nivelin e 60%-shit, që është një nivel nën mesatare. Kjo tregon se sistemi i akreditimit ka filluar të punojë dhe ky draft që vjen pas 2 vjetësh do të përmirësojë edhe komponentët e tjerë.

Tani të dal te kostot. Sipas mendimit tim ky projektligj sot ka kosto politike dhe për rrjedhojë nuk duhet të kalojë në gjendjen që është. Ky ligj sot ka kosto sociale, prandaj nuk duhet të kalojë në gjendjen që është.

Po ndaloj pak te kostot sociale, pikërisht lidhur me sa interesa ndërron dhe sa interesa cenon. Ligji, në fakt, u nis nga ideja që të mbronte interesat e studentëve më të mirë, pra që nesër në tregun e punës të mos konkurrojnë ai që ka blerë diplomën, por që ka aftësitë e duhura për të zënë një vend pune të rëndësishëm. Pra, fryma e ligjit dhe fryma e idesë duhej të ishte mbrojtja e cilësisë së lartë. Për këtë të gjithë ata e diskutuan si ide, sepse ideja doli nga e gjithë tryeza. Të gjithë u bashkuan me shqetësimin që ne sot kemi në treg një cilësi të diskutueshme. Kjo cilësi cenon studentët që janë të mirë, pavarësisht se diplomohen në universitetet publike ose private.

Ka kosto sociale pa diskutim, sepse në formën që është cenon familjen. Nëse futet një cikël i plotë provimesh nga e para në një paketë të re, ju garantoj që një pjesë e konsiderueshme do të bien. Familjet kanë harxhuar ekonomikisht, kanë shpenzuar kohë, kanë shpenzuar energji. Gjithashtu, nuk mundet që pas një studimi pesëvjeçar në dy palë nivele të vësh një paketë provimesh nga e para. Pra, do të thotë që jemi para një skeme shumë të vështirë, ku materializimi i idesë është larguar nga ideja.

Tani marrim bazën e të gjithë juristëve, që do të kalojnë në këtë filtër. Ishte qëllimi që të hynin të tjerë pa përjashtim, nuk ishte fare kjo ide. Ishte ideja, siç është në të tërë botën, që

disa profesione, që kanë licencimin që prek interesa publike të forta duhet të kenë një cilësi që t'i përgjigjet këtij standardi. Kështu që në këto lloj analizash që bëjmë sot, unë them se duhet të jemi të detyruar të riformatojmë idenë. E kam thënë në të gjitha takimet ku kam qenë pjesë, në fakt, kam qenë pjesë në të gjitha takimet jo nga fakti që isha eksperte e edukimit ligjor, sepse ndër ekspertet që e kam shkruar këtë ligj, dua ta bëj të qartë këtë pjesë. Ky ligj ka një eksperiencë gjermane që vjen edhe si rezultat i eksperiencës krahasuese nga eksperti i EURALIUS-it që punonte në këtë fushë. Ne, në fakt, bashkohemi edhe me propozimin e zotit Hoxha. Nuk është e lehtë në Shqipëri të bashkosh dy sisteme, pasi sistemi gjerman ta jep diplomën pas provimit të dytë të shtetit, kurse sistemi shqiptar të fut në provim me diplomë. Kjo do të thotë se shteti ka përgjegjësi dhe nuk mund t'i thotë studentit: ik se ta gris diplomën, thënë në mënyrë metaforike “ta djeg diplomën”. Jo, nuk ishte ky qëllimi.

Prandaj, unë them që jemi në kohën e duhur të bëjmë korrektim thelbësor. Nuk ishte ideja që të bëjmë qendra gjigante me komisione të reja, ky cenon edhe ekipin e pedagogëve.

Bashkohem, gjithashtu, me mendimin e pedagogëve të juridikut. Është nonsens të thuash që në këto komisione nuk mund të ketë njerëz nga nivelet akademike. Nuk ka sens. Kush do t'i korrigjojë atëherë testet?

Meqenëse e nisa me kostot, unë them që ka edhe kosto financiare. Të ngresh një ekip të madh, a e dini çfarë ideje ishte? Ishte ideja e një qendre certifikimi që bënte një *scantron*, lehtësonte edhe provimin e avokatisë, edhe provimin e magjistraturës. Pse të detyrohemi ne të bëjmë provim minimal të *scantroni*? Një person rri në një kompjuter, që do të thotë, bëj një nivel bazik, sepse neni 5 i ligjit e ka qëllimin, në fakt, por nenet e tjera nuk i përmbahen qëllimit.

I dëgjova të gjithë parafolësit dhe jam shumë e sigurt që zonja Hysi, për respekt, përmendi emrin tim dhe të profesoreshë Artës. Ne nuk jemi autore të këtij ligji, por kemi qenë në grupin ideator, që ka studiuar me shumë kujdes të gjithë arsimin që nga kopshti, me një studim individual vullnetar që ia vuri në dispozicion Kuvendit në mënyrë që të realizoheshin këto gjëra. Bashkë me zotin Haxhia kemi qenë pjesë e atij grupi të këtij komisioni që kemi paraqitur gjithmonë komente dhe analiza. Gjithmonë edhe me zotin Haxhia janë bërë shpesh herë mbledhje të dy komisioneve. Kështu që idenë e kemi të shënuar në ligj me 3/5-tat, tani hajdeni t'i kthehemi idesë origjinale.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Semini!

Fjalën e ka zoti Demo.

Artur Demo - Faleminderit!

Së pari, unë do të doja të nënvizoja disa arritje që kanë rezultuar pas miratimit të ligjit të arsimit të lartë dhe disa nisma që Ministria e Arsimit ka ndërmarrë dhe po ndërmerr sa i përket garantimit të cilësisë që ofrojnë jo vetëm Fakulteti i Drejtësisë, por edhe institucionet e arsimit të lartë në të gjitha fushat e studimit.

Ne kemi një proces të përfunduar të akreditimit nga pikëpamja institucionale e atyre institucioneve që funksionojnë në territor. Në Fakultetin e Drejtësisë procesi i standardizimit të kurrikulave ka arritur deri në 70% të programit të studimit në fushën e drejtësisë. Kjo nënkupton që do të kemi një lloj standardizimi të njohurive që studentët përfitojnë gjatë kohës që ata janë të regjistruar në një program studimi Bachelor, master, që normalisht do të jetë program i integruar 5-vjeçar.

Së dyti, unë do të nënvizoj rëndësinë që nuk mund të krijojmë struktura paralele në bazë të çdo lloj profesioni që operon në vend. Nëse ne u referohemi profesioneve të detyruara, tashmë kemi një standard të organizimit të provimeve dhe, gjithashtu, ka struktura të ngritura sa i përket rregullimit të këtij procesi. Nëse ne do të pranonin që në programet e drejtësisë duhet të kemi një strukturë paralele të mbarëvajtjes së provimeve, atëherë ne ngremë dyshime që pjesa tjetër nuk funksionon. Kështu që unë mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm në këtë drejtim. Ne kemi një qendër të shërbimeve arsimore, e cila menaxhon të gjitha provimet sa u përket profesioneve të rregulluara, në mjekësi, infermieri e të tjera. Normalisht këto janë kapacitete të ngritura, të cilat nuk mundet të anashkalohen

Sa i përket mënyrës së menaxhimit, këto provime menaxhohen në bashkëpunim me ata që praktikojnë fushën ose pjesën akademike. Rrjedhimisht jemi dy grupe, i pari harton tezën e provimit, që janë pedagogët e fushës në këtë rast. Duhej të ishte Ministria e Arsimit dhe e Drejtësisë që të ngrinin një grup pune me ekspertë të fushës, që do të ishin praktikantë ose profesorë, të cilët do të hartonin tezat e provimit dhe më pas do të ngrihej edhe një grup tjetër pune, që do të merrej me korrigjimin.

Tani, sa i përket nivelit të matjes së njohurive që dëshirojmë të arrijmë nëpërmjet këtij testimi, është një çështje që duhet të diskutohet dhe është e nivelit teknik sa i përket stekës që ky provim duhet të garantojë për formimin bazë që duhet të ketë një i diplomuar në drejtësi.

Gjithashtu, unë nuk dua të paragjykoj qëllimin e mirë që është synuar me vendosjen e një filtri ekstra sa i përket cilësisë së studentëve që ne diplomojmë në këto programe studimi, duke marrë në konsideratë edhe impaktet specifike që kanë të diplomuarit në këtë fushë, por duke thënë këtë gjë ne duhet të gjejmë një balancë në mes ruajtjes së të drejtave që kanë studentët, sepse ne nuk mund të bëjmë ndarje të mëdha mes studentëve të brezave të ndryshëm, ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm për këtë gjë, por në të njëjtën kohë duhet të jemi të

kujdesshëm sa u përket kostove, që u përmendën edhe nga zoti Metani, të cilat do të jenë për individin, familjen dhe institucionet.

Duke qenë ish-anëtar i grupit për reformën në arsimin e lartë, besoj fort në eksperiencën e ekspertëve të fushës nga Fakulteti i Drejtësisë dhe ne si Ministri Arsimit jemi të gatshëm të akomodojmë një proces që garanton kredibilitet, garanton nivelin e filtri, që është i domosdoshëm sa u përket të diplomuarve në drejtësi, kjo në bashkëpunim edhe me aktorët pjesë e sistemit, sa i përket objektivit që ne duhet të realizojmë.

Së fundi, nëse neve na jepet roli i profesionit të rregulluar ne funksionojmë në bazë të urdhrave. Nëse ne do të pranohet mocioni i një profesioni të rregulluar, jemi të detyruar të ecim me të njëjtën logjikë. Nëse do të ecim me logjikën e një provimi, që garanton një minimum të njohurive përkatëse, siç dëgjova këtu, unë besoj se ekziston fleksibiliteti dhe ne mund të gjejmë kreativitetin e duhur për mekanizmat e caktuar, që ky të jetë një provim që menaxhohet në mënyrë të përqendruar dhe garanton uniformitetin sa i përket mënyrës së vlerësimit në rang kombëtar.

Patjetër pastaj çdo profesion specifik që vjen nga fushat përkatëse, avokatët kanë qoftë formimin për testimet e tyre, gjyqtarët po ashtu, prokurorët po ashtu, e të tjerë me radhë, kështu që unë mendoj të jemi të kujdesshëm që ta bëjmë sistemin fleksibël, por që të garantojë ato gjëra, të cilat u përmendën nga kolegët më parë, që kanë qenë nocioni thelbësor i futjes së kësaj gjëje.

Gjykoj se drafti në formën siç është sot ka vend për diskutim, përmirësim dhe marrjen në konsideratë të sistemit, që kemi tashmë të ndërtuar, pasi nuk mund të hedhim poshtë çdo gjë që kemi në funksion, sepse, ndryshe ngremë një dyshim për çdo sistem që jemi duke përdorur sot. Mendoj se kjo gjë nuk i bën mirë jo vetëm sistemit, por besoj se i bën dëm edhe provimit që ju dëshironi të bëni për programet e drejtësisë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Demaj!

Fjalën e ka kërkuar zonja Baçi, përfaqësuese e Universitetit të Shkodrës, Fakulteti i Drejtësisë.

Entela Baçi – Së pari, ju falënderoj për ftesën!

Më bëhet qejfi që jemi ende në diskutimin në parim të këtij projektligji. Nga mënyra se si ishte hartuar ftesa, krijova idenë sikur do të diskutonim projektligjin e prezantuar.

Si përfaqësuese e një universiteti relativisht të vjetër, duke e krahasuar me fakultetet e reja private, nuk kam si të mbaj qëndrim ndryshe nga kolegët e nderuar të akademisë.

Për sa i përket prezantimit të këtij projektligji, kisha disa pyetje ose vërejtje, të cilat do të doja të merreshin parasysh në rast se ky projektligj do të miratohet.

Te neni 4, te përkufizimet, një student që mbaron studimet në “La Sapienza” që unë e kam koleg, apo një student që ka mbaruar studimet në Hamburg dhe mund të jetë koleg në Universitetin e Tiranës, për të punuar si jurist në administratën publike, duhet të hyjë në testim për të dhënë provimin e shtetit. Qëllimi i ligjit, prezantohet fare qartë te relacioni dhe të gjithë bashkëndajmë shqetësimin e inflacionit të diplomave. Çështja është se si duhet ta zgjidhim këtë problem. Nuk po i hy përsëritjes së argumenteve. Ndërkohë, a nuk shkelet parimi i barazisë, në rastin kur një student, i cili është diplomuar në juridik, e ka diplomën dhe bashkë me të ka edhe tregun e punës, që nuk e ka përdorur ende diplomën, sepse është pa punë, ndërsa, me një student tjetër që ka mbaruar studimet tek Universiteti “Kristal”, punon si drejtues, apo është nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues, pra, ka hyrë në punë? Ai që ka hyrë në punë le të rrijë, sepse përndryshe i shkelet parimi i së drejtës kushtetuese për punë, ose shkelet edhe parimi i sigurisë juridike për diplomën e fituar.

Aspekti tjetër është parimi i barazisë. A nuk shkelet ky parim në momentin kur....

Nuk po bëj vërejtje, por po bëj sugjerime në variantin e rishikimit të ligjit, që do të thotë, nëse do ta bëjmë patjetër një ligj të tillë, të jetë për studentët që fillojnë juridikun, jo për ata që po e mbarojnë atë. Mendoj që nuk duhet të jetë as për një student që tashmë është në vitin e parë për juridik, sepse ai hyn me idenë e garantimit të një diplome, që mbas 6 vjetësh, që janë kufizimet që u kemi vënë universiteteve, do të ketë një Bachelor, pastaj ndoshta SEC-i nuk ua gjen tregun e punës.

Është e panevojshme ta them që të forcohen testimet e Shkollës së Magjistraturës, por tek avokatia, noteria të gjejmë një mënyrë për të forcuar sistemin tonë universitar, të forcojmë diplomat tona.

Ndërsa për universitetet që u mbyllën, të gjendet një mënyrë për të vështirësuar përdorimin e diplomave që janë blerë.

Faleminderit!

Ulsi Manja –Faleminderit, zonja Baçi!

Fjalën e ka kërkuar zoti Matlia, nga ResPublika.

Dorian Matlia – Faleminderit!

Shkurtimisht, do të doja të thosha një mendim të pavarur si pjesë e shoqërisë civile...

Ulsi Manja –Mendimi i pavarur, në fakt, ka më tepër vlerë!

Dorian Matlia –Në parim jemi të mendimit që ky projektligj nuk duhet të kalojë, të tërhiqet si nismë në mënyrë tërësore, sepse e tha edhe zonja Semini edhe parafolësja, që kemi të bëjmë me vënien në pikëpyetje të diplomës, jo në vënien në pikëpyetje të njohurive. Gjermania, për shembull, vë në pikëpyetje njohuritë dhe më pas të jep diplomën, dhe jo siç po

ndodh me sistemin që po propozohet te ne. Sigurisht, këtu kemi cenim të parimit të sigurisë juridike e të gjitha me radhë.

Të diplomuar në drejtësi jemi shumë në këtë sallë, gjithashtu edhe unë, por a do të kalojmë të gjithë në provim? Jo, sepse mënyra si është hartuar drafti, për të mos diskriminuar të tjerët “në pikëpyetje, ma vini edhe diplomën time, ju lutem!”. Pra, nisma është bazuar në problemin që është konstatuar me disa nga diplomat e disa viteve të caktuara, në disa shkolla të caktuara, që kanë pasur probleme dhe janë në pikëpyetje, por nuk mund të merret një masë, e cila vë në pikëpyetje të gjitha diplomat e të diplomuarve në Shqipëri si juristë për të zgjidhur këtë problem. Arsyeja e dytë pse është propozuar kjo, është edhe unifikimi i certifikimit të cilësisë. Për shembull, Dhoma Kombëtare e Avokatisë bën një provim të unifikuar, që e certifikon dhe e vlerëson një kandidat, çfarë rëndësie ka nëse i ka bërë studimet në privat, në publik apo mund ta ketë blerë diplomën. Kur të shkojë të bëjë testimin si gjithë të tjerët te Dhoma Kombëtare e Avokatisë, do ta marrë atë provim në një standard të unifikuar vlerësimi. E njëjta gjë është për noterët, përmbaruesit e kështu me radhë.

Pra, shoh që kjo mbivendosje për të vënë në pikëpyetje diplomat më jep të drejtën të mendoj se edhe diplomat tona, që jemi në këtë sallë, ky ligj na i vë në pikëpyetje, ose përndryshe tërhiqemi fare nga kjo nismë, pasi do të ishte më mirë sistemi që është aktualisht.

Faleminderit!

Ulsi Manja –Faleminderit, zoti Madlia!

Fjalën e ka kërkuar zoti Gogu, zëvendësministër i Drejtësisë.

Toni Gogu – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar profesorë,

Të nderuar kolegë,

Në rolin e zëvendësministrit të Drejtësisë, ministria do të konstatojë dy momente shumë të rëndësishme: provimi i shtetit nuk është një pasmëndësim. Ai është një hallkë, siguresë shumë e rëndësishme cilësie e reformës në drejtësi. Ka ardhur si nevojë e analizës që kanë bërë ekspertët, komisioni i veçantë, është parashikuar në strategjinë ndërsektoriale të drejtësisë si një objektiv i veçantë, është parashikuar, gjithashtu, në të gjithë paketën kryesore të kaluar me shumicë të cilësuar. Pra, provimi i shtetit nuk është pasmëndësi, por hallkë e rëndësishme e sigurisë cilësore.

Konstatimi i dytë që ne bëjmë është rregullimi me ligj i provimit të shtetit. Ne çmojmë, vlerësojmë, konstatojmë që ky duhet të kryhet pas një vlerësimi të impaktit rregullativ. Tashmë, me miratimin e këtij instrumenti që kemi bërë në qeveri, kërkohet që qeveria duhet të marrë e të vlerësojë impaktin rregullativ që sjell një projektligj i tillë.

Duke qenë shumë i kursyer në koment, ju falënderoj për ftesën dhe mundësinë që të paraqesim mendimin tonë!

Ulsi Manja –Po, zoti Haxhia.

Maks Haxhia – Unë e kam ndjekur në gjenezë të gjithë problemin dhe për shkak të vazhdimësisë, ish-ministri Manjani, pra ministria, ka mbajtur një qëndrim dhe ka qenë kundër. Nuk e di cilat janë arsyet që ju çuan ju ta vlerësonit këtë?

Toni Gogu – Profesor, pyetja juaj është shumë e drejtë! Ju falënderoj!

Opinionin e ministrit, të cilit i referoheni, është i vitit 2015, një kohë kur asnjë nga dokumentet e rëndësishme që përmenda më sipër nuk ishin miratuar, por ishin ende duke u diskutuar.

Faleminderit!

Ulsi Manja –Fjala për zonjën Kejda Meta.

Kejda Meta - Përsëritje të gjithëve!

Quhem Kejda Meta, nga Departamenti i Administratës Publike.

Pa u zgjatur, do të veçoj vetëm dy momente duke e parë këtë projektligj në këndvështrimin e impaktit që do të sjellë në administratën publike. Po ndalem, pikë së pari, te provimi i shtetit.

Neni 5 sanksionon që qëllimi i këtij provimi është garantimi i një standardi minimal njohurish, (për ligjin), sistemin ligjor dhe institucional nëpërmjet organizimit të një provimi të centralizuar, të unifikuar, objektiv, të paanshëm e me radhë. Sot që flasim, qëllimi i këtij projektligji përbën boshtin e legjislacionit të shërbimit civil. Duke qenë se sot niveli hyrës në administratën publike, por jo vetëm, edhe lëvizja e mobilitetit brenda saj, qoftë nëpërmjet lëvizjes paralele, qoftë nëpërmjet promovimit të ngritjes në detyrë, kalon patjetër nëpërmjet një sistemi konkurrimi në të cilin kandidatët testohen për atë fushë njohurish, për atë legjislacion bazik me të cilin do të punojnë. Mendoj se nëpërmjet këtij sistemi rekrutimi që kemi sot në administratën publike, qëllimi i ligjit është realizuar për nivelin hyrës, dhe jo vetëm. Ky mekanizëm, ky filtër është siguruar për të testuar njohuritë shtesë.

Së dyti, doja të ndalesha te neni 6 “E drejta për të ushtruar disa profesione ligjore”, ku ndër të tjera sanksionohet si kusht kalimi me sukses i provimit të shtetit. Ndër të tjera është edhe kusht për pranimin në karrierën profesionale në administratën publike në nivel qendror dhe vendor. Këtu mendoj që do të duhej të bëhej një definicion më i saktë.

Sot që flasim, në administratën publike nuk kemi vetëm të diplomuar në drejtësi, që ushtrojnë mirëfilli detyrat e një juristi, të tipit dhënie të asistencës juridike, përfaqësimit në gjykatë të institucionit me palët e treta etj., por kemi edhe të diplomuar në shkenca juridike, të

cilët kryejnë detyra të tipit specialistë të burimeve njerëzore apo specialistë prokurimesh. A do të jenë ata targetgrup i këtij projektligji?

Gjithashtu, në vitin 2017 bëmë edhe ndryshime në VKM-në që specifikon përshkrimet e punës dhe disa kriteret minimale për disa pozicione që ne i konsiderojmë pozicione horizontale, që i gjen pothuaj në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, me propozimin e universiteteve, që të mos vendosnim standard të lartë, vetëm master shkencor për specialistët. Për këtë arsye u bë ndryshimi i VKM-së e në veçanti u specifikua, që për pozicionet e specialistëve, në institucionet rajonale, nëpër qarqe dhe ato vendore, duke pasur parasysh edhe ofertën e tregut të punës, niveli minimal të ishte Bachelor.

Ulsi Manja –Faleminderit!

Zonja Bernhard, nga misioni EURALIUS, ka një opinion për diskutimet që po bëhen.

Agnes Bernhard – (*Përkthen përkthyesi*)

Një element i rëndësishëm, si dhe parim europian është edukimi, cilësia e lartë e edukimit. Shqipëria, edhe në vazhdimin e procesit të anëtarësimit në familjen europiane, do të duhet të marrë tërë masat e nevojshme, ka edhe mbështetje për të marrë masat e mundshme për rritjen në vazhdimësi të nivelit të edukimit, në mënyrë që studentët shqiptarë të jenë të jenë gjithmonë sa më afër dhe sa më konkurrentë me sivëllezërit e simotrat e tyre në vendet e tjera europiane.

Ulsi Manja – Po, faleminderit!

Po, zoti Hoxha! Zoti Hoxha e ka kërkuar përsëri fjalën.

Artan Hoxha – Meqenëse e nisa, thashë ta mbyll.

Nga kjo tavolinë mendoj se ju e morët opinionin tonë. Nuk është vetëm opinionin e personave që janë në këtë tavolinë, por janë shumë të tjerë ata që ne përfaqësojmë. Unë mendoj se problematikat që ne kemi në jetën e përditshme nuk zgjidhen duke shtuar hallka ligjore dhe duke shtuar mund më tepër për ata që duhet t'i kalojnë.

Kemi zgjedhur një sistem dhe duhet të ecim me një sistem. Nuk mund të kombinojmë dy sisteme që nuk kombinojnë me njëri-tjetrin. Ose do të marrim modelin gjerman ose do të mbajmë modelin që kemi. nëse reforma ecën, ajo nuk ecën në mënyrë metafizike, por ecën në mënyrë dialektike. Kur janë diskutuar tre vjet më parë çështjet e reformës në drejtësi, e reforma për arsimin e lartë, edhe reforma e arsimit juridik, që ishte pjesë e paketës së dytë, janë diskutuar në një moment të caktuar kohor. Sot kemi një moment tjetër kohor.

Megjithatë, me gjithë diferencën në kohë, nga mbledhja e datës 17. 2. 2017, jo në këtë sallë, por në atë sallën tjetër atje, ku kemi qenë shumë më tepër se kaq, ne i kemi thënë komisionit se ky projekt nuk duhet të kalojë. Po të doni rekordet, i keni të plota. Mbledhjen e

ka kryesuar zonja Vasilika me zotin Xhafaj. Projekti që ne kemi sot është apo ai i datës 17. 2. 2017.

Është shumë e vërtetë ajo që tha profesoresha: kemi interes publik dhe interes të individit, por në dëm të interesit publik nuk mund të vëmë interesat e individit. Interesin publik e garantojmë me sistemin që kemi. Sistemi që kemi të garanton sipas fushave ku shkon. Nëse do të shkosh në avokati, duhet të bësh shkollën e avokatisë. Nëse do të shkosh në administratë publike, dhe nëse administratës publike nuk i funksionojnë mirë komisionet, të forcojë veprimtarinë e vet. Por nëse në ligj ti thua: “standard minimal i njohurive”, nuk ke thënë asgjë, sepse standardi minimal i njohurive nuk të shërben për të futur as në avokati, as në magistraturë, as në administratë publike dhe as kudo. Me standard minimal ti je për të dalë në treg, por që të ngresh standardin duhet të zhvillohesh më tutje.

Kështu, unë do ta konsideroja këtë në dëm të interesave të studentëve, edhe me një “vështirësi” në të kuptuarin e procesit të diplomimit. Nëse Kushtetuta na thotë se arsimi iu lartë, si të gjitha arsimimet e tjera, ka një rend, do të thotë se përgjegjës për arsimin e lartë janë institucionet e arsimit të lartë, do të thotë se institucionet e arsimit të lartë të diplomojnë. Në Gjermani nuk të diplomojnë institucionet e arsimit të lartë, por të diplomon provimi i shtetit, provimi i dytë i shtetit. Po kalove të parin, ke dy vjet në dispozicion për të kaluar të dytin. Në atë kohë, mua më qëlloi të isha në Gjermani për programin gjerman të arsimit të lartë, që po mendonin ta reformonin. Ok, s’ka rëndësi kjo, por rëndësi ka që u vura në dijeni të një situatë që mund të mos e dija. Diploma është provimi i shtetit në Gjermani. Nëse diploma këtu është provimi i shtetit, ne duhet të krijojmë Urdhrin e Juristit pastaj, atëherë ne nuk kemi pse t’i bëjmë ato provime që bëjmë sot. Duhet të rrëzojmë të gjithë ligjin për arsimin e lartë dhe të themi se i diplomuar në Shqipëri është ai që kalon provimin e shtetit. Madje jo ky provim, por duhet të jetë provim-provim ai. Atëherë duhet ta marrim modelin gjerman ashtu siç është. Nuk mund të marrim vetëm një gjë të vogël, e pastaj të ecim me sistemin që kemi ndërtuar. Tashmë e kemi të ndërtuar sistemin. Ishte gabim kjo futje në ligjin “Për arsimin e lartë”. Edhe unë mendoj se zgjidhet shumë thjesht: shfuqizohet kjo dispozitë e nenit 82. Nuk ke nevojë të prekësh asnjë dispozitë tjetër në legjislacionin që ke kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Reforma në drejtësi është bazuar jo në konkluzionet e reformës, por në një ligj që është në fuqi. Ligji ka qenë i vitit 1995, ka qenë në fuqi kur ka ardhur në konkluzione. Ne kemi marrë të mirëqenë një legjislacion që s’ishte problem i reformës. Ishte një ligj në fuqi, të cilin ti duhej ta respektoje. Nëse këtë e shfuqizon, ato mbeten automatikisht pa vlerë, sepse s’ke provim shteti, ose do të bësh interpretim se ç’kupton me provim shteti, që është diploma e secilit institucion.

Paaftësia për të kontrolluar, paaftësia për të koordinuar, paaftësia për të standardizuar, paaftësia për të vënë para përgjegjësisë ata që nuk e ushtrojnë siç duhet funksionin, nuk duhet të zgjidhet me ligje, me procedura e me një vargan studentësh, që pastaj të përfundojnë sikur po bëjnë doktoraturë apo profesorë të asociuar. Ne të rrisim mekanizmat e aplikimit të ligjit, që i kemi të plota, dhe nuk kemi nevojë të krijojmë situata të tilla.

Unë kam bërë një shënim dhe po e them, e kam shkruar këtu: “Kjo është t’i përzësh me ligj jashtë vendit studentët shqiptarë”. E kam kurajën ta them, sepse me ligj do t’i thuash atij, që ti do të bësh më shumë nga ç’bën një student jashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu, unë mendoj se kjo nuk e ndihmon as studentin shqiptar, as familjen shqiptare dhe as arsimin shqiptar. Jam dakord me Agnesin, që duhet të rrisim standardet, por reforma nuk është për studentin. Reforma është për institucionet. Edhe reforma për arsimin e lartë, edhe reforma për drejtësinë janë që të rritet performanca e atyre që e ofrojnë arsimin, e atyre që e ofrojnë drejtësinë, por jo e palëve. T’u themi palëve në gjykatë tashti: rriteni ju performancën? Jo. Them që gjykata duhet të bëhet më e mirë, prokuroria duhet të bëhet më e mirë, arsimi duhet të bëhet më i mirë. Nuk mund t’i themi studentit: bëj provime më tepër!

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hoxha!

Në fakt, nëse nuk ka komente të tjera, ma bëre më të lehtë mbylljen e kësaj tryeze të konsultimit publik. Dua të them vetëm një fjalë, me sa kuptova unë nga gjithë ky diskutim. Fakti se sistemi i edukimit juridik nuk ka qenë apo nuk është në gjendje të mbrojë dot veten, kurrësi nuk duhet të jetë premisë për ta shkarkuar barrën tek studentët dhe familjet e studentëve. Kjo është çështja finale. Prandaj i themi studentit: përmirësohu ti, sepse nuk jemi në gjendje të përmirësohemi ne!

Në fakt, duhet të jetë krejt e kundërta. Të gjithë jemi për rritjen e cilësisë në arsimin e lartë, e veçanërisht për Fakultetin e Drejtësisë, por unë, personalisht, jam goxha i sqaruar ose i ndriçuar, le të themi, në lidhje me këtë projektligj. Sigurisht, në fund, vendimmarrja është politike, në kuptimin që do ta vendosin deputetët, do ta vendosë komisioni se çfarë do të bëhet me nismën, por mendimet e kësaj tryeze do të influencojnë jo pak në natyrën e vendimmarrjes sonë politike. Sepse, në fund të fundit, përballë mendimit të ekspertëve të fushës, përballë botës akademike dhe profesoratit, edhe politika do të duhet të reflektojë në mënyrën e duhur. Të gjithë jemi për më të mirën, të gjithë jemi për interesin publik, por në rastin konkret prevalon interesi i studentëve të fakulteteve të drejtësisë, por edhe i familjeve shqiptare, që investojnë për shkollimin e fëmijëve.

Gjithsesi, duke ju falënderuar një për një në lidhje me pjesëmarrjen në tryezën e sotme, nuk dua t'i marr të gjithë me radhë, sepse një pjesë i lexova në fillim, por një pjesë u vetëprezantuan gjatë diskutimit, por dua t'ju falënderoj për pjesëmarrjen e sotme në tryezë. Po ashtu, dua të falënderoj përfaqësuesit e institucioneve qendrore, që ishin pjesë e kësaj tryeze. Në mënyrë të veçantë dua të falënderoj misionin EURALIUS, zonjën Bernhard, e cila si përherë i ndjek të gjitha tryezat e konsultimit që ne bëjmë në Komisionin e Ligjeve, por edhe me aktorët e tjerë të interesit.

Një falënderim të veçantë e kam për mediet, që sot në fakt, si ditë e premte do t'u kenë munguar lajmet e tjera, që erdhën dhe e ndoqën me shumë interes këtë tryezë.

Edhe një herë: faleminderit e ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA